



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**  
MINISTRI

Nr. 1302 prot.

Tiranë, më 08/03/2020

**URDHËR**

Nr. 134, datë 08.03.2020

**PËR**

**VETËKARANTINIMIN E PERSONAVE QE HYJNË NË TERRITORIN E SHQIPËRISË NGA ZONA E IZOLUAR NË ITALI**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7 dhe nenit 17, gërma "dh" e Ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", Vendimit të datës 8.03.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri", me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019.

**URDHËROJ:**

1. Të gjithë shtetasit që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe vijnë nga zona e izoluar në Itali, të vetëkarantinohen për një periudhë 14 ditore në ambientet e banesave të tyre si një masë parandaluese për mospërhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-2019.
2. Strukturat shëndetësore të sigurojnë mbikqyrjen e vazhdueshme të të gjithë personave të identifikuar si persona që kanë hyrë në vendin tonë nga zona e izoluar në Itali.
3. Moszbatimi i këtij urdhëri nga personat që hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga zona e izoluar në Itali, është i dënueshëm sipas dispozitave të nenit 35 të Ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik dhe të gjithë strukturat përgjegjëse shëndetësore në të gjithë zonat ku janë personat e vetëkarantinuuar.

Ky urdhër hyj në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Ogerta Manastirliu**